



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 150

Tiranë – E mërkurë, 29 shtator 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 13243, datë 23.9.2021	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 14279
Udhëzim i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 18, datë 24.9.2021	Për përcaktimin e kushteve të tregjeve të kafshëve të gjalla..... 14279
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 393, datë 27.9.2021	Për delegim kompetencash..... 14281
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 413, datë 24.9.2021	Për marrjen e masave për parandalimin e infeksionit COVID-19, për personelin e institucioneve arsimore dhe studentët..... 14281
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 413/1, datë 27.9.2021	Për një ndryshim në urdhrin nr. 413, datë 24.9.2021, “Për marrjen e masave, për parandalimin e infeksionit COVID-19, për personelin e institucioneve arsimore dhe studentët”..... 14282
Vendim i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit nr. 14, datë 14.9.2021	Bibliografia e Informacionit të Deklasifikuar në AIDSSH..... 14283
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 3212/7, datë 27.9.2021	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Ndërtimi i unazës së qytetit Bajram Curri, faza II”, Tropojë..... 14285

**DEKRET****Nr. 13243, datë 23.9.2021****PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93, të Kushtetutës, si dhe të neneve 13, 14, 20, 23 dhe në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Zhelka (Željka) Zhivko (Živko) Brajović (Brajović)
2. Zhelko Zhivko (Živko) Brajović (Brojaj)
3. Ilir Luan Zejneli
4. Anita Rushit Zejneli (Huda)
5. Ali Lian Ilir Zejneli
6. Aylin Ilir Zejneli
7. Julja Agim Prodani
8. Gjyljana Agim Beqiri
9. Dorina Xhevahir Hanaj
10. Entela Fejzo Hasa (Zhillla)
11. Dea Ylli Mici
12. Shpend Sadik Gashi
13. Nikola (Nikolaos) Kostika Çakalli (Tsakali)
14. Edlira Gani Çakalli (Koldashi/Cakalli)
15. Antonia Kostika Çakalli (Tsakali)
16. Vilma Astrit Shabani (Haka)
17. Katalena Dorjan Shabani
18. Ariola Seid Osmani (Goshi/Gashi)
19. Jetlirë Mehmet Osmani
20. Jasmin Jetlirë Osmani
21. Armina Jetlirë Osmani
22. Elida Memush Bocaj
23. Erblin Agust Nushi
24. Vivien Sindi Bardh Ukaj
25. Anita Bardhyl Ukaj
26. Kristina Tomi Tuci (Bardhi)
27. Naim Kadri Memishaj
28. Diesa Naim Memishaj
29. Silvana Avni Guddat (Xhebrahimi)
30. Leonit Sabedin Vokri
31. Lorik Sabedin Vokri
32. Ervis Gjon Lleshaj

33. Donalda Predrag Surdučki

34. Megi Ervis Lleshaj

35. Indrit Hamid Meti

36. Bujar Ismail Bakiu

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

UDHËZIM**Nr. 18, datë 24.9.2021****PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE TË
TREGJEVE TË KAFSHËVE TË GJALLA**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë; të pikës 3, të nenit 65, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:**I. QËLLIMI**

Ky udhëzim përcakton kushtet e përgjithshme, të veçanta, teknike dhe sanitaro-veterinare, për ngritjen dhe funksionimin e tregjeve të kafshëve të gjalla, me qëllim ruajtjen e shëndetit publik dhe shëndetin e mirëqenien e kafshëve.

II. KËRKESA TË PËRGJITHSHME

1. Tregjet e kafshëve blegtorale ngrihen vetëm në vendet e miratuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, pas plotësimit të kushteve të përcaktuara në këtë udhëzim.

2. Tregjet e kafshëve blegtorale duhet të respektojnë kriteret mjedisore dhe kushtet e lejes së mjedisit, për të minimizuar impaktin social-mjedisor në zonë, si dhe të garantohet lidhje e përshtatshme e tyre me rrugët nacionale, me qëllim mënjanimin e pengesave në qarkullimin rrugor.

3. Territori i destinuar për treg të kafshëve të gjalla, të mos ketë shërbyer si vend groposjeje e kafshëve të ngordhura apo si vendgrumbullim i mbeturinave, për të paktën 20 vjetët e fundit, sipas konfirmimit të njërive bashkiake.



4. Tregjet të funksionojnë sipas legjislacionit në fuqi në fushën e veterinarisë, licencimit, mjedisit dhe shoqërive tregtare.

III. KËRKESA TË VEÇANTA

Territori i destinuar për treg të kafshëve të gjalla duhet të ketë:

1. Sipërfaqe për kafshët e gjalla të përlogaritur në minimumin, sipas llojeve:

- a) për gjedh: 2 m² për krerë;
- b) për kuaj: 3.5–4 m² për krerë;
- c) për dele: së paku 1.2 m² për krerë;
- ç) për derra: 1 m² për krerë;
- d) për qengja dhe gica: 0.5 m² për krerë;
- dh) për shpendët: jo më shumë se 33 kg për m² peshë e gjallë.

2. Objektet ndihmëse, të cilat mundësojnë kryerjen e aktiviteteve të tregut të kafshëve.

3. Objektin e zyrës së veterinerëve të vendosur në hyrje të tregut dhe të ketë sistem kompjuterik të lidhur me internet, që mundëson hyrjen në sistemin e informacionit blegtoral dhe veterinar RUDA.

4. Të jenë nën kontrollin e përhershëm të një veterineri zyrtar të AKVMB-së. Veterineri zyrtar i AKVMB-së, që kryen shërbimin veterinar në treg, në fund të ditës pasqyron në sistemin RUDA hyrjen dhe daljen e të gjitha kafshëve në treg, bazuar në certifikatën veterinare, që shoqëron lëvizjen e kafshëve në treg. Kafshët që dalin nga tregu duhet të shoqërohen me certifikatën shëndetësore veterinare për lëvizjen e kafshës të lëshuar nga veterineri zyrtar, përgjegjës për tregun.

5. Çdo treg i kafshëve, para miratimit nga AKVMB-ja, në procesin e licencimit duhet të ketë thertore sanitare ose kontratë me një thertore në afërsi, ku mund të kryejë therjet emergjente – sanitare të kafshëve.

6. Territori i tregut duhet të jetë i shtruar me material të qëndrueshëm i cili mund të lahet, pastrohet dhe dezinfektohet lehtë.

7. Territori i tregut i destinuar për shitjen e kafshëve të gjalla të llojeve shpendë, kafshë shoqëruese ose kafshë ekzotike duhet që të jetë i ndarë në hapësirë dhe kafshët të jenë në kafaze të veçantë.

IV. KËRKESA TEKNIKE

Territori i destinuar për treg të kafshëve të gjalla duhet të ketë:

1. Një hyrje dhe një dalje të veçantë;

2. Rrethim me lartësi prej 2 m për t'u penguar hyrjen dhe daljen e palejuar nga tregu të kafshëve;

3. Të paktën një pjesë të mbuluar, në mënyrë që të ruhet shëndeti i kafshëve të ndjeshme nga ndikimet atmosferike, si: dielli, reshjet dhe kushtet e tjera ambientale;

4. Në hyrje dhe në dalje të tregut duhet të jenë vendet për pastrimin dhe dezinfektimin e njerëzve, kafshëve dhe mjeteve të transportit;

5. Tregu të jetë i pajisur me mjete të përshtatshme për pastrimin dhe dezinfektimin e hapësirave, për izolimin e kafshëve dhe të kamionëve;

6. Një vend ku mjeti i transportit të lahet, pastrohet dhe dezinfektohet pas shkarkimit të kafshëve;

7. Një vend të posaçëm (rampat) për ngarkimin dhe për shkarkimin më të lehtë të kafshëve;

8. Ndriçim të mjaftueshëm;

9. Një ndarje të veçantë për kafshët e dyshuara për sëmundje apo të sëmurë;

10. Hapësira të mjaftueshme ku kafshët ndahen sipas llojit dhe kategorisë;

11. Me qëllim të mirëqenies së kafshëve, tregu duhet të ketë vendin e veçantë për kafshët me të vegjlit e tyre;

12. Vendet për lidhjen e kafshëve, për kafshët e mëdha. Për kafshët e imta hapësira të rrethuara dhe për shpendët vendin ku do të vendosen kafazet e tyre. Këto duhet të mundësojnë dhënien e ujit të pijshëm, ushqimin dhe të kenë kanalizim për largimin e mbeturinave;

13. Ambiente që janë të pajisura me mjete dhe hapësira të përshtatshme për kontrollin shëndetësor veterinar;

14. Mjekun veterinar të pranishëm në treg, që nuk duhet të lejojë heqjen e matrikujve nga kafsha;

15. Ambientet përkatëse dhe të përshtatshme për magazinimin e ushqimit, të mbeturinave dhe të plehut;

16. Të jetë i pajisur me një sistem të përshtatshëm për mbledhjen e ujërave të shkarkimit;

17. Asnjë ambient i vendit të grumbullimit të mos përdoret për therje;

18. Ambientet e tregut të pastrohen dhe të dezinfektohen periodikisht përpara funksionimit të tyre, sipas udhëzimeve të veterinerit zyrtar të kontrollit;

19. Të ketë të paktën një ditë të plotë ndërmjet një tregu dhe tjetrit, gjatë së cilës mund të kryhet pastrimi dhe dezinfektimi.



Plotësimi i kushteve të mësipërme verifikohet dhe kontrollohet nga AKVMB-ja.

V. HYRJA DHE DALJA NGA TREGU

1. Shoqëruesi i kafshës, i cili ka në administrim kafshët e gjalla, dorëzon te veterineri zyrtar i pranishëm në treg, dokumentacionin dhe shoqërimin e kafshëve.

2. Të gjitha kafshët e gjalla që hyjnë dhe dalin nga tregu, duhet të shoqërohen me dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) certifikatën shëndetësore veterinarë për lëvizjen e tyre;
- b) autorizimin e miratimit të mjetit të transportit;
- c) pasaportën;
- ç) vërtetimin për dezinfektimin e mjetit të transportit.

Dokumentacioni shoqërues pasqyrohet në sistemin RUDA, të administruar nga veterineri zyrtar, që mbulon kontrollin zyrtar veterinar të tregut.

VI. DISPOZITA KALIMTARE

1. Hapja e tregjeve të reja të kafshëve bëhet pasi të kenë plotësuar kushtet e përcaktuara me këtë udhëzim dhe vetëm pas miratimit nga AKVMB-ja, që kushtet në këto tregje janë në përputhje të plotë me këtë udhëzim.

2. Tregjet ekzistuese të kafshëve janë të obliguara që t'i plotësojnë kushtet e tregjeve, në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi, në afatin prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi.

3. Ngarkohet Drejtoria e Politikave dhe Programeve të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

URDHËR

Nr. 393, datë 27.9.2021

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar; të neneve 28 e 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar; të nenit 21, pika 5, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, dhe të nenit 73, pika 2, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor për procedurat e prokurimit, në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Sekretarit të Përgjithshëm.

2. Delegimi i kompetencave mbaron me revokimin e aktit të delegimit.

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm.

4. Urdhri nr. 74, datë 11.2.2021, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

URDHËR

Nr. 413, datë 24.9.2021

PËR MARRJEN E MASAVE PËR PARANDALIMIN E INFEKSIONIT COVID-19, PËR PERSONELIN E INSTITUCIONEVE ARSIMORE DHE STUDENTËT

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 7, të nenit 18, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar, të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, të Komitetit të Ekspertëve të Imunizimit të datës 29.8.2021, si edhe në zbatim të



vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirus i ri nr. 3614 prot., datë 30.8.2021, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019

URDHËROJ:

1. Të gjithë personat që rrezikohen dhe përbëjnë rrezik për të tjerët, për të penguar përhapjen e sëmundjeve infektive përmëshin detyrimet e përcaktuara në nenin 18, pika 7, germa “a/ii”, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar.

2. Personeli i institucioneve arsimore dhe studentët, si një ndër kategoritë e përfshira në pikën 1, të këtij urdhri, duhet të depozitojnë pranë qendrës së punës dhe studentët pranë zyrave të përcaktuara nga IAL-të përkatëse, Certifikatën e Vaksinit COVID-19 nga *e-Albania* apo kartën e vaksinit.

3. Për punonjësit e institucioneve arsimore që nuk paraqesin Certifikatën e Vaksinit COVID-19 apo kartën e vaksinit, do të kërkohet paraqitja, çdo javë, e testit PCR, të kryer sipas procedurës për kryerjen e testeve për efekte administrative, për të verifikuar që nuk janë mbartës të infeksionit Sars-Cov-2, duke filluar nga data 27.9.2021.

4. Për studentët që nuk paraqesin Certifikatën e Vaksinit COVID-19 apo kartën e vaksinit, drejtuesit e Institucioneve të Arsimit Universitar të marrin masa për ofrimin e studimit në platforma alternative, duke filluar nga 11.10.2021.

5. Institucionet arsimore të identifikojnë personelin e institucionit arsimor dhe studentët që kanë depozituar Certifikatën e Vaksinit COVID-19 apo kartën e vaksinit dhe të raportojnë pranë Institutit të Shëndetit Publik informacion mbi identifikimin e kryer.

6. Përjashtim nga rregullat e përcaktuara në këtë urdhër bëhet vetëm për rastet që kanë indikacion mjekësor të përcaktuar me dokument mjekësor për mosaplikimin e vaksinës.

7. Instituti i Shëndetit Publik të marrë masat dhe të monitorojë mbulimin vaksinal të grupet e përmendura në pikën 2 të këtij urdhri dhe të raportojë në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

8. Ngarkohet Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Instituti i Shëndetit Publik të bashkëpunojnë me institucionet e arsimit të lartë, për zbatimin e këtij urdhri.

9. Ky urdhër i përcillet ministrisë përgjegjëse për arsimin.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

URDHËR

Nr. 413/1, datë 27.9.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 413, DATË 24.9.2021, “PËR MARRJEN E MASAVE, PËR PARANDALIMIN E INFEKSIONIT COVID-19, PËR PERSONELIN E INSTITUCIONEVE ARSIMORE DHE STUDENTËT”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të pikës 7, të nenit 18, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar; të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, të Komitetit të Ekspertëve të Imunizimit të datës 29.8.2021, si edhe në zbatim të vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirus i ri nr. 3614 prot., datë 30.8.2021, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 413, datë 24.9.2021, “Për marrjen e masave, për parandalimin e infeksionit COVID-19, për personelin e institucioneve arsimore dhe studentët”, bëhet një ndryshim si më poshtë vijon:

1. Pika 4 riformulohet si më poshtë vijon:

“4. Studentët duhet të paraqesin certifikatën e vaksinit COVID-19 apo kartën e vaksinit, për të hyrë në institucionet e arsimit të lartë, duke filluar nga data 11.10.2021.”.

2. Ky urdhër i përcillet ministrisë përgjegjëse për arsimin.



Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

VENDIM

Nr. 14, datë 14.9.2021

**BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË
DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH**

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar ‘Sekret shtetëror’, të ndryshuar; kreu III, neni 13, pika “b”; në vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”; kreu II, neni 4, pikat “a”, “c”, dhe në udhëzimin nr. 99, datë 13.4.2018, “Për zbatimin e vendimit nr. 662, datë 15.11.2017, për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”, në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 13, datë 3.5.2018, të kryetarit të Autoritetit, “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar, ‘Sekret shtetëror’, të ndryshuar në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, me vendimin nr. 14 datë 14.9.2021, si më poshtë:

I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. Dosje e problemit të centralizuar nr. 1076, “Shushunja”, 123 (njëqind e njëzet e tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”. Dosja i përket Fondit ish-Dega IV.

2. Fashikull nr. 9626, në ngarkim të S.G., me 5 (pesë) fletë në total. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Fashikulli i përket Fondit ish-Kosova.

3. Dosje formulare nr. 1106, në ngarkim të A.H., me 117 (njëqind e shtatëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është – “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Pogradec.

4. Dosje përpunimi nr. 510, në ngarkim të A.Xh., me 67 (gjashtëdhjetë e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Përmet.

5. Fashikull nr. 1331, në ngarkim të H.Ç., me 91 (nëntëdhjetë e një) fletë në total. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Fashikulli i përket Fondit ish-Të Arratisur.

6. Dosje kërkimi dhe dosje formulare nr. 963/3, në ngarkim të Z.H., me 47 (dyzet e shtatë) fletë në total. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit ish-Të Arratisur.

7. Dosje formulare nr. 1442, në ngarkim të DH.V.L., me 108 (njëqind e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Shkodër.

8. Fashikull nr. 6, në ngarkim të DH.V.L., me 4 (katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”. Dosja i përket Fondit ish-Dega IV, F. Rezervë.

9. Dosje agjenturore nr. 3094 “Nëpërka”, me 38 (tridhjetë e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit Ish-Operativ.

10. Dosje personale dhe pune nr. 1451, në ngarkim të M.D., me 108 (njëqind e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”. Dosja i përket Fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Shkodër.

11. Regjistër agjente nr. 1. Model K.I., me 190 (njëqind e nëntëdhjetë) fletë, fillon me nr. rendor 1 dhe mbaron me numrin rendor 2451, në total janë 61 (gjashtëdhjetë e një) fletë të plotësuar. Niveli i klasifikimit të regjistrit është “Tepër sekret”. Regjistri i përket fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Mirditë.

12. Fondi 4, Drejtoria I, dosje nr. 142, viti 1990. Të dhëna të Drejtorisë III mbi një refugjat kosovar me mbiemrin G. dhe mbi disa punonjës e vizitorë nga Jugosllavia. Dosja ka 4 (katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

13. Fondi 4, Drejtoria I, dosje nr. 345/3, viti 1974. Informacion dërguar udhëheqjes së Partisë së Shtetit mbi miratimin e masave të pleniumit V Komiteti Qendror nga ana ushtarake për dënimin e armikut të partisë B.B. Dosja ka 3 (tri) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

14. Fondi 4, Drejtoria I, dosje nr. 330, viti 1974. Informacion i Degës së Sigurimit të Ushtrisë mbi komentet armiqësore nga radhët e ushtarakëve për grupin komplotist të B.B. Dosja ka 14 (katërmëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes



është “Sekret”.

15. Fondi 4, Drejtoria I, dosje nr. 418, viti 1967. Korrespondencë me Degët e Punëve të Brendshme mbi verifikimin e shkaqeve të vetëmbyties së inxhinier **L.F.**, plani i masave dhe relacioni mbi këtë problem. Dosja ka 14 (katërmëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

16. Fondi 4, Drejtoria I, dosje nr. 370, viti 1974. Informacione e relacione mbi të dhënat që kanë dalë mbi veprimtarinë e komplotistëve të **B.B.**, si dhe shënime operative mbi tradhtarët. Dosja ka 48 (dyzet e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

17. Fondi 4, Drejtoria I, dosje nr. 95, viti 1975. Informacione të Degës së Ushtrisë mbi komentet armiqësore në radhët e ushtrisë për grupin komplotist të **B.B.** dhe ngjarje të tjera në ushtri. Dosja ka 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

18. Fondi 4, Drejtoria I, dosje nr. 369, viti 1974. Informacione dërguar Komitetit Qendror të Partisë mbi komentet armiqësore rreth tradhtisë së **B.B.** dhe mbi disa deponime të ish-ushtarakut **A.Q.** Dosja ka 6 (gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

19. Fondi nr. 4, Drejtoria I, dosje nr. 42, viti 1985. Udhëzim i MPB-së nr. 01–51, datë 23.5.1985, mbi detyrat e punëtorëve operativë, që shoqërojnë grupe kulturore sportive jashtë shtetit. Dosja ka 7 (shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

20. Fondi nr. 4, Drejtoria e Dosje nr. 123, viti 1990. Informacion i Drejtorisë III mbi dy grupe turistike nga SHBA-ja, që kërkojnë të vizitojnë vendin tonë. Dosja ka 6 (gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

21. Fondi nr. 4, Drejtoria I, Dosje nr. 184, viti 1990. Mbi disa grupe turistike me qëndrim stabël në Durrës. Dosja ka 26 (njëzet e gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

22. Fondi nr. 4, Drejtoria I, dosje nr. 125, viti 1985. Korrespondencë e thjeshtë për grupet turistike. Dosja ka 128 (njëqind e njëzet e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

23. Fondi nr. 4, Drejtoria I, dosje nr. 90, viti 1987. Për ardhjen e grupeve turistike dhe trajtimin e tyre. Dosja ka 9 (nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

24. Fondi nr. 4, Drejtoria I, dosje nr. 81, viti 1985. Informacione të bëra për drejtimin e shoferëve, grupeve kulturore-sportive. Dosja ka 192 (njëqind e nëntëdhjetë e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

25. Fondi nr. 4, Drejtoria I, dosje nr. 64, viti 1987. Mbi grupet turistike greke dhe disa turistë grekë. Dosja ka 5 (pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

26. Fondi nr. 4, Drejtoria I, dosje nr. 57, viti 1988. Për grupet turistike që vijnë në Shqipëri dhe ansamblin tonë folklorik në Ohër. Dosja ka 10 (dhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

27. Fondi nr. 4, Drejtoria I, dosje nr. 62, viti 1988. Për disa reagime të grupeve turistike suedeze dhe italiane. Dosja ka 15 (pesëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

28. Fondi nr. 4, Drejtoria I, dosje nr. 65, viti 1988. Për disa reagime të grupeve turistike e të disa tregtarëve grekë të ardhur në vendin tonë. Dosja ka 47 (dyzet e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

29. Fondi nr. 4, Drejtoria I, dosje nr. 64, viti 1988. Për reagime të grupeve turistike angleze. Dosja ka 42 (dyzet e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

30. Fondi nr. 4, Drejtoria I, dosje nr. 63, viti 1988. Për reagime turistike të ardhur vende të ndryshme. Dosja ka 20 (njëzet) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

31. Fondi nr. 4, Drejtoria I, dosje nr. 76, viti 1988. Për ardhjen në vendin tonë të grupeve turistike dhe disa komente të huajve për shërbimet e interklubit. Dosja ka 70 (shtatëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

32. Fondi nr. 4, Drejtoria I, dosje nr. 90, viti 1988. Miratime për grupe vizitorësh që duan të vijnë në vendin tonë. Dosja ka 70 (shtatëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

33. Fondi nr. 4, Drejtoria I, dosje nr. 90, viti 1988. Për disa probleme që dalin për trajtimin e grupeve turistike, që vijnë në vendin tonë. Dosja ka 7 (shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

34. Fondi nr. 4, Drejtoria I, dosje nr. 42, viti 1989. Mbi disa reagime të grupeve turistike greke. Dosja ka 6 (gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.



35. Fondi nr. 4, Drejtoria I, dosje nr. 48, viti 1989. Për disa probleme të uljes së numrit të grupeve turistike. Dosja ka 3 (tri) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

36. Fondi nr. 4, Drejtoria I, dosje nr. 294, Viti 1986. Korrespondencë zhvilluar ndërmjet KQ-së së PPSH e MPB-së për zgjidhjen e kërkesave të **N.SH.** për stabilizim e banim të **I.A.** e **A.A.** në Tiranë, dërguar Sektorit I të KQ-së së PPSH-së. Dosja ka 4 (katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

37. Fondi nr. 4, Drejtoria e Dosje nr. 69, viti 1983. Informacion mbi turneun e trupës së baletit dhe orkestrës sinfonike në Greqi, dërguar **K.Q.** të PPSH-së, Këshillit të Ministrave. Dosja ka 7 (shtatë) fletë.

38. Fondi nr. 4, Drejtoria II, dosje nr. 60, viti 1958. Dosje e objektit për Klerin Bektashian, historiku i tij. Rregullorja mbi administrimin e brendshëm. relacioni i grupit të klerikëve për reformimin e Klerit, përshkrim mbi vrasjen e B.F. etj. Dosja ka 79 (shtatëdhjetë e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

39. Fondi nr. 4, Drejtoria I, dosje nr. 196, viti 1990. Informacione të Drejtorisë III mbi përpjekjet e organeve të UDB-së për dërgimin e agentëve jugosllavë në vendin tonë nëpërmjet grupeve turistike. Dosja ka 7 (shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

40. Fondi nr. 4, Drejtoria I, dosje nr. 197, viti 1990. Informacione mbi grupet turistike të shqiptarëve të Malit të Zi ardhur në vendin tonë në muajt prill–maj 1990. Dosja ka 16 (gjashtëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

41. Fondi nr. 4, Drejtoria I, dosje nr. 198, viti 1990. Mbi disa komente të bëra nga grupe turistike të ardhur në Durrës e Tiranë nga Jugosllavia. Dosja ka 21 (njëzet e një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

42. Fondi nr. 4, Drejtoria I, dosje nr. 204, viti 1990. Për disa komente të grupeve të ndryshme turistike e vizitorëve të ardhur në vendin tonë. Dosja ka 26 (njëzet e gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

43. Fondi nr. 4, drejtoria I, dosje nr. 205, viti 1990. Mbi komentet e reagimet e disa të ftuarve të ardhur kohët e fundit në vendin tonë. Dosja ka 5 (pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

44. Fondi nr. 4, Drejtoria I, dosje nr. 206, viti 1990. Për disa reagime, interesime, vlerësime e qëndrime nga të huaj të ndryshëm që kanë ardhur në Shqipëri. Dosja ka 32 (tridhjetë e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

45. Fondi nr. 4, Drejtoria I, dosje nr. 213, viti 1990. Mbi reagimet dhe qëndrimet e disa grupeve turistike të ardhur nga Greqia. Dosja ka 26 (njëzet e gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

46. Fondi nr. 4, Drejtoria I, dosje nr. 195, viti 1990. Mbi grupet turistike kosovare, komente të të huajve etj. Raporte të analizës vjetore. Dosja ka 26 (njëzet e gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

KRYETAR I KOMISIONIT TË
DEKLASIFIKIMIT DHE ZHVLERËSIMIT
Gentiana Sula

KËRKESË
Nr. 3212/7, datë 27.9.2021

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Ndërtimi i unazës së qytetit Bajram Curri, faza II”, Tropojë.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Tropojë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogarit, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, për pasuritë e llojit “truall”, dhe bazuar në vendimin nr. 138, datë 23.3.2000, për pasuritë e llojit “ndërtesë”, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 13 425 681 (trembëdhjetë milionë e katërqind e njëzet e pesë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë një) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR
I KOMISIONIT TË POSAÇËM TË
SHPRONËSIMEVE
Erlis Hereni



LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE TË PASURIVE, PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT “NDËRTIMI I UNAZËS SË QYTETIT BAJRAM CURRI”, FAZA II

Nr.	Emër Atësi Mbiemër	Të dhënat mbi pasurinë				Vlerësimet për shpronësim sipas llojit të pasurisë					Vlera totale në lek	Adresa	Shënime sqaruese
		ZK	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. totale m²	Shpronësim tokë “truall”			Shpronësim Ndërtesë				
						Sip. (m²)	Çmimi (lek/m²)	Vlera (lek)	Sip. e ndërtesës e konfirmuar nga ASHK-ja (m²)	Vlera e llogaritur me situacion (lek)			
1	Uke Bajram Hysenukaj	1347	7/54-ND	Ndërtesë	41				41	1017487	1017487	Lagjja “Dardania”	Ndodhet në truallin me nr. pasurie 7/53
2	Naim Qazim Haklaj	1347	7/53-ND	Ndërtesë	22.8				22.8	623497	623497	Lagjja “Dardania”	Ndodhet në truallin me nr. pasurie 7/55
3	Nurie Bajram Hysenukaj Adriana Sadri Boshnjaku Afërdita Sadri Demiraj Alma Sadri Çakraj Arben Sadri Hysenukaj	1347	7/79	Godinë	34.16	34.16	1873	63982	34.16	988 644	1052626	Lagjja “Dardania”	
4	Kreshnik Petrit Katana Jutbina Petrit Katana Juliana Petrit Katana Bekim Petrit Katana	1347	7/57-ND	Ndërtesë	57				57	1161153	1161153	Lagjja “Dardania”	Ndodhet në truallin me nr. pasurie 7/57
5	Kujtim Hamez Osmani Astrit Hamez Osmani	1347	7/211-ND	Ndërtesë	28				28	760359	760359	Lagjja “Dardania”	Ndodhet në truallin me nr. pasurie 7/211
6	Kujtim Hamez Osmani Astrit Hamez Osmani	1347	7/213-ND	Ndërtesë	33				33	835256	835256	Lagjja “Dardania”	Ndodhet në truallin me nr. pasurie 7/213
7	Bute Selim Neziraj	1347	7/56-ND	Ndërtesë	17.76				17.76	548793	548793	Lagjja “Dardania”	Ndodhet në truallin me nr. pasurie 7/56
8	Shkëlzen Qazim Gjeçaj	1347	7/66	Godinë	50.9	50.9	1873	95336	50.9	1358582	1453918	Lagjja “Dardania”	Blokohet pas. në favor të shoqërisë “FAF”
9	Gani Binak Malizi	1347	7/99	Godinë	85.38	85.38	1873	159917	85.38	1928978	2088895	Lagjja “Dardania”	Blokohet pas në favor të shoqërisë “FAF”
10	PPV	1347	7/67	Godinë	100	100	1873	187300	54	1092496	1279796	Lagjja “Dardania”	Posedohet nga Agim Motina
11	Kadri Sokol Mustafaj Hamdi Sokol Mustafaj Isa Sokol Mustafaj	1347	7/70	Truall	431	431	1873	807263			807263	Lagjja “Dardania”	Mbi këtë pasuri janë 2 ndërtime pa leje
12	Bedri Haxhi Islamukaj	1347	7/92	Truall	250	34.23	1873	64113			64113	Lagjja “Dardania”	Ndalohen veprimet mbi pasurinë
13	Shtet	1347	7/54	Truall	119	119	1873						



14	Shtet	1347	7/53	Truall	51	51	1873						
15	Shtet	1347	7/57	Truall	82	82	1873						
16	Shtet	1347	7/56	Truall	33	33	1873						
17	Shtet	1347	7/211	Truall	51	51	1873						
18	Shtet	1347	7/213	Truall	51	51	1873						
19	Saimir Ahmet Malaj Enida Sadik Malaj	1347	10/42	Truall	1500	75	1873	140475			140475	Lagjja “Partizani”	
20	Halil Mal Gjongecaj	1347	10/27/9	Truall	837	75	1873	140475			140475	Lagjja “Partizani”	
21	Halil Mal Gjongecaj	1347	10/27/10	Truall	1141	95	1873	177935			177935	Lagjja “Partizani”	
22	Lulzim Adem Rrahmanaj Zeqir Sali Bushgjokaj	1347	10/27/12	Truall	2270	220	1873	412060			412060	Lagjja “Partizani”	
23	Skënder Ahmet Mella Lirie Ahmet Mulaj Azgan Ahmet Mella	1347	10/27/3	Truall	1236	115	1873	215395			215395	Lagjja “Partizani”	
24	Raze Cole Boshnjaku Shpëtim Idris Gjongecaj Dea Fatmir Gjongecaj Bekim Fatmir Gjongecaj Lida Idriz Kuçana Teuta Veli Hajdari	1347	10/27/2	Truall	491.5	35	1873	65555			65555	Lagjja “Partizani”	
25	Besnik Ahmet Alia	1347	10/27/1	Truall	723	15	1873	28095			28095	Lagjja “Partizani”	
26	Saimir Ahmet Malaj	1347	10/195	Truall	1155	250	1873	468250			468250	Lagjja “Partizani”	
27	Besnik Ahmet Alia	1347	10/21/1	Truall	1088	45	1873	84285			84285	Lagjja “Partizani”	
Vlera totale paraprake								3110435			13425681		

Shënim: 1. Vlerësimi i pasurisë së llojit “tokë truall” është kryer bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016.

2. Vlerësimi i pasurisë “Ndërtesë” është kryer bazuar në VKM-në nr. 138, datë 23.3.2000.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 48 lekë